

Rami Saari, hebreu që përkthen letërsinë shqipe

Dr. Jorina Kryeziu – Profil

Rami Saari (17.9.1963–, Petah-Tikva, Izrael) është përkthyes, poet, gjuhëtar, redaktor, kritik letrar dhe ligjërues në disa universitete të botës. Autor i tetë vëllimeve poetike dhe përkthyes, prej disa gjuhëve të huaja, i shtatëdhjetë e shtatë librave në prozë e në poezi, thuhet të gjitha të shoqëruara me shënime prej tij, parathënie a pasthënie. Qysh në moshë të re tregoi talent në zotërimin e shumë gjuhëve. Sot, ai është poliglot, njohës i shtatëmbëdhjetë gjuhëve: hebraisht (gjuha amë), finlandisht, greqisht, spanjisht, portugalisht, katalanisht, hungarisht, suedisht, estonisht, polonisht, rusisht, anglisht, arabisht, turqisht, galicianisht, maltezisht, mes të cilave edhe shqip.

Në Argjentinë kaloi fëmijërinë e hershme, ndërsa kur ishte 4 vjeç u kthye sërish në vendlindje. Arsimin fillor e atë të mesëm e kreu në vendlindje, në Petah-Tikva, qytet që ndodhet në lindje të Tel Avivit. Gjatë periudhës së shkollës së mesme mësoi finlandishten e pas kryerjes së detyrimit ushtarak u zhvendos në Helsinki, ku studioi gjuhësi dhe letërsi. Studimet e larta i kreu në Universitetin Helsinki (Finlandë), përgjatë viteve 1983–1989 dhe 1990–1992, ku studioi gjuhët semitike, uralike, gjuhë dhe letërsi greke e hungareze etj. Qysh në mars të vitit 1987, ende pa u diplomuar, filloi të shkruajë tekste këngësh, shkrime kritike, si dhe të përkthejë poezi, proza, sprovat letrare dhe kritika letrare për shtëpitë botuese izraelite, revistat letrare dhe gazetat ditore. Në shtator 1989 deri në janar 1990 qëndroi në Hungari, në Universitetin “Eötvös Loránd” (Budapest), për të mbledhur materiale për temën e masterit, të titulluar “Huazimet semite në hungarisht”. Në vitin 1991 u certifikua si mësues i gjuhës hebraike nga Universiteti Hebraik i Jerusalemit. Më 2003 mbrojti shkëlqyeshëm (Summa cum laude) tezën e Doktoraturës, drejtimi Gjuhësi, me titull “Milót ha-jáxas ha-Maltézijot”/“Parafjalët në gjuhën malteze” (krahasuar me ato semitike), në Universitetin Hebraik të Jerusalemit, Fakulteti i Shkencave Humane, udhëhequr nga profesorët Gideon Goldenberg dhe Alexander Borg. Në të njëjtin vit, punimi i tij i doktoratës fiton çmimin “Bloomfield” dhe botua nga shtëpia botuese “Carmel” (Jerusalem).

Ligjërues:

- i gjuhës dhe i letërsisë hebraike në Universitetin Veror të Helsinkit, Finlandë (1983–1992, 1994; 2014–2018);
- i gjuhës dhe i letërsisë hebraike në Shkollën e Biblës në Helsinki, Finlandë (2017);
- zëv.lektor i Studimeve të Lindjes së Mesme, në Universitetin e Helsinkit, Finlandë (dy semestra, 2014);
- Trajnim i avancuar gjuhësor, Hebrew High School Teachers, Neta Program, Hebrew College, Boston, Masaçusets, SHBA (2003–2013);
- i maltishtes, Departamenti i Gjuhësisë, Universiteti Hebre i Jerusalemit, Izrael (1999–2002);
- i finlandishtes dhe i studimeve uralike, Departamenti i Gjuhësisë, Universiteti Hebre i Jerusalemit, Izrael (1996–2002);
- i gjuhësisë së përgjithshme, Departamenti i Gjuhësisë, Universiteti Hebre i Jerusalemit, Izrael (1995–2002);
- i gjuhës hebraike, Rothberg International School, Universiteti Hebre i Jerusalemit, Izrael (1992–1998);
- i gjuhës dhe i letërsisë hebraike në Universitetin Helsinki, Finlandë (1990–1991);
- i gjuhës dhe i letërsisë hebraike, The Jewish School, Helsinki, Finlandë (1990–1991);
- i gjuhës dhe i letërsisë hebraike, Universiteti “Eötvös Loránd”, Budapest, Hungari (1989–1990);
- i gjuhës dhe i letërsisë hebraike, në Universitetin e Helsinkit, Finlandë (1984–1989).